

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-2/09

Prishtinë

5 Maj 2011

P.L.

Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi:

kundër

I.B.

Pala përgjegjëse /Pala përgjegjëse në ankesë:

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Gjyqtarja Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit dhe Gjyqtarët Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesë Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/34/2008, (shkresat e lëndës të regjistruara në AKP nën numrin KPA10359), të datës 19 dhjetor 2008, pas shqyrtimit të mbajtur më 5 Maj 2011, lëshon këtë

AKTGJYKIM

- 1- Ankesa e P.L. refuzohet si e pabazuar.
- 2- Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/34/2008 i datës 19 Dhjetor 2008 vërtetohet.

- 3- Shpenzimet e procedurës në shumën prej € 80 (tetëdhjetë euro) do t'i bart ankuesi, P.L., dhe do t'i paguhet Gjykatës Supreme brenda 90 ditësh nga dorëzimi i aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Historiku faktik dhe procedural:

Më 18 Nëntor 2002, P.L. paraqiti një kërkesë në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) duke kërkuar t'i njihet e drejta posedimit për apartamentin në sipërfaqe prej 90, 55 m², që gjendet në Rrugën Sremska L-5, hyrja VIII, hyrja 8, numri i banesës 8, në Prishtinë.

Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore me vendimin e tij të lëshuar më 18 Qershor 2004, refuzoi kërkesën me arsyetim se paraqitësi i kërkesës nuk kishte sjellë provat se kishte qenë ndonjëherë posedues i pronës së diskutueshme.

Më 27 Tetor 2004, paraqitësi i kërkesës dorëzoi një kërkesë në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore për ri-konsiderim.

Ky Komision refuzoi kërkesën me vendim të datës 9 dhjetor 2004, duke konsideruar se pala që ka paraqitur kërkesën nuk kishte ofruar asnjë provë ligjore përkatëse që nuk është marrë parasysh nga Komisioni kur fillimisht ka marrë vendim mbi kërkesën, si dhe kërkesa për ri-konsiderim nuk ka zbuluar asnjë gabim material në zbatimin e Rregullorës së UNMIK-ut 2000/60.

Më 6 Korrik 2007, paraqitësi i kërkesës dorëzoi një kërkesë në AKP, duke kërkuar ri-posedim të pronës së lartpërmendur.

Ai pohoi se përkundër asaj se banesa objekt kontesti në këtë lëndë i është ndarë atij në përputhje me Ligjin mbi Marrëdhëniet Banesore, ai nuk mundi ta marrë atë në posedim, së pari, deri më 24 Mars 1999, sepse banesa ende nuk ishte pranuar teknikisht pas ndërtimit të saj, pastaj, pas 14 Qershorit 1999, për arsye se i frikohej keqtrajtimit për shkak të përkatësisë etnike të tij si rezultat i konfliktit dhe se banesa ishte në posedim të paligjshëm nga pala përgjegjëse dhe familja e tij.

Në mbështetje të kërkesës së tij, ai i ofroj AKP-së dokumentet si në vijim:

- Vendimi Nr. 360-2749 i Sekretariatit për Çështje Komunale dhe Rezidente të Kuvendit Komunal të Prishtinës të datës 19 Janar 1999 që ia jep atij banesen në fjalë me qira për një periudhë të pacaktuar;
- Kontratën mbi qiranë për banesën e përmendur Nr. 68/1 të lidhur më 19 Shkurt 1999 në mes atij si qiramarrës dhe Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë si qiradhënës;
- Kontratën mbi bashkimin e mjeteve Nr. 02-1679/1 të lidhur më 9 Shtator 1998 në mes Ndërmarrjes Publike Banesore në Prishtinë dhe Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Me vendimin e tij të datës 19 dhjetor 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK ose Komisioni) refuzoi kërkesën pasi që verifikimi i dy dokumenteve të para që mbështesin kërkesën nuk lejoi gjetjen e tyre në shënimet e zyrave publike përkatëse dhe, përkitazi me të tretën, tregoi se kontrata asnjëherë nuk kishte hyrë në fuqi në mënyrë të vlefshme.

Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se ka pranuar vendimin e KKPK-së më 10 Qershor 2009.

Më 23 Qershor 2009, paraqitësi i kërkesës (tash e tutje ankuesi) paraqiti një ankesë në Gjykatën Supreme kundër vendimit të lartpërmendur.

Në ankesën e tij, ai pohoi se vendimi i ankimuar ishte i paqartë, i pakuptueshëm dhe kundërthënës, se nuk përmend a është mbajtur seanca publikisht apo jo, kush ishin anëtarët e Komisionit, kush ishte Kryesuesi i Komisionit dhe kush e nënshkroi atë.

Ai po ashtu theksoi se emri, pozita dhe aftësia e të folurit të gjuhës e përdorur në kërkesë për personin raportues nga AKP-aj nuk janë përmendur në vendimin e kontestueshëm.

Ai kundërshtoi vendimin grupor të KKPK-së, me pretendim se ai nuk kishte lidhje me paraqitësit e tjerë të kërkesës dhe se kërkesa e tij nuk ishte e bazuar njësoj sikur kërkesat e tjera të trajtuara me të njëjtin vendim.

Ai më tutje kundërshtoi se vendimi ishte marrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke marrë parasysh se vetë fakti se AKP-ja nuk ka marrë të njëjtat dokumente si ato që ai i ka dorëzuar nuk e arsyeton hedhjen poshtë të kërkesës së tij. Ai i mohoi të gjitha pohimet mbi të cilat

pala përgjegjëse në ankesë do të kishte fituar të drejtën e shfrytëzimit të banesës nga Ndërmarrja Publike Banesore, duke e vlerësuar vendimin e tillë si arbitrar dhe të pamjaftshëm të mënjanojë vlefshmërinë e vendimit të mëparshëm në dobi të tij.

Në fund, ai pohoi se pala përgjegjëse në ankesë dhe familja e tij iu kishin afruar atij me qëllim të blerjes së banesës, dhe tregoi se ky qëndrim dëshmon se ai është pronar ligjor.

Si përfundim i këtyre argumenteve, ai kërkoi që vendimi i ankimuar të anulohet, ankesa e tij të pranohet, pala përgjegjëse të obligohet ta lirojë banesën nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe që banesa t'i dorëzohet atij në posedim dhe shfrytëzim.

Sipas Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së, pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar ankesën dhe më 3 shtator 2010 ka konfirmuar se ka pranuar një kopje të ankesës. Megjithatë, ai nuk ka parashtruar asnjë përgjigje.

Arsyetimi ligjor:

Vendimi i shkallës së parë i është dorëzuar paditësit më 10 Qershor 2009. Në përputhje me Nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, pala mund të parashtrojë ankesë brenda tridhjetë ditësh pas njoftimit të vendimit. P.L. parashtroi me kohë ankesën e tij më 23 Qershor 2009 prandaj ankesa e tij është pranueshme.

Si çështje paraprake, Gjykata Supreme vëren se supozimi i palës përgjegjëse në ankesë në bazë të cilit vendimi i KKPK-së do të ishte *“i paqartë, i pakuptueshëm dhe kundërtbënës”* fare nuk është mbështetur me asnjë argument të mëtutjeshëm dhe/ose detaj. Një kritikë e tillë ndaj vendimit të shkallës së parë është tepër e përgjithësuar dhe duket më shumë si një përshkrim i një ndenjeje të plotë të përceptuar në mënyrë subjektive nga i tërë vendimi, kështu që Gjykata nuk mund të merret me vlerësimin e palës përgjegjëse në ankesë lidhur me mungesën e pretenduar të saktësisë apo qëndrueshmërisë.

Argumentet e tjera të ngritura nga pala përgjegjëse në ankesë në njërën anë janë lidhur me rregullsinë procedurale (II) të vendimit të shkallës së parë, e në anën tjetër lidhur me vendosjen meritore të kësaj ankese (III).

Megjithatë, pikë së pari, Gjykata Supreme, duke marrë parasysh se ishin lëshuar dy vendime të shkallës së parë, duhet të vërtetojë sa a është lëshuar vendimi i ankimuar edhe pse kërkesa është gjykuar më herët me anë të një vendimi të mëparshëm të formës së prerë (I).

I-Res judicata:

Gjykata Supreme do të shqyrtojë vendimin e ankimuar mbi bazën e Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) 03/L-006 (Gazeta Zyrtare e Kosovës Nr. 38, 20 shtator 2008), e cila në përputhje me Nenin e saj 538, hyri në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare, para lëshimit të vendimit të ankimuar më 19 Dhjetor 2008. Si rezultat i kësaj, është i zbatueshëm në lëndën në fjalë.

Në përputhje me Nenin 194 të LPP-së, gjykata e shkallës së dytë do ta shqyrtojë *ex officio* se a ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore siç përcaktohet në Nenin 182.2.

Në përputhje me Nenin 182.2 i) të LPP-së, gjithnjë ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore nëse vendimi është lëshuar lidhur me një lëndë e cila është gjykuar më herët me aktgjykim të formës së prerë.

Kjo dispozitë e obligon Gjykatën Supreme të verifikojë nëse ekziston një situatë *res judicata* kur KKPK-ja ka lëshuar vendimin e vet pasi që KKPB më parë e kishte lëshuar një vendim të formës së prerë më 9 Dhjetor 2004. Parimi në bazë të të cilit *res judicata* nuk duhet të shqyrtohet prapë nga një tjetër gjykatë zbatohet kur kërkesa e njëjtë për të njëjtën çështje paraqitet për herë të dytë në shkallë të parë nga i njëjti paditës kundër të njëjtit të paditur.

Në këtë lëndë, nga shkresat e lëndës së KKPB-së dhe KKPK-së, paraqiten këto ngjashmëri: paraqitësi i kërkesës është P.L.; kërkesa mbështetet nga dokumentet e njëjta dhe kërkon njohje të së drejtës së posedimit për të njëjtën banesë. Në lëndën përpara KKPB-së, palë përgjegjëse ishte Afërdita Bajrami dhe para KKPK-së, paraqitësi i kërkesës po ashtu e identifikoi Afërdita Bajramin si shfrytëzuese të tanishme të banesës së diskutueshme të cilës iu është dorëzuar kërkesa, por, pastaj, pala përgjegjëse është identifikuar nga AKP-ja si babai i saj, I.B..

Edhe pse pala përgjegjëse ishte tjetër, Gjykata Supreme duhet të marrë parasysh se ligjvënësi ka ngritur procedura të veçanta për tu marrë me çështjet e veçanta në vijim: kërkesat lidhur me diskriminimin gjatë periudhës kohore prej 23 Marsit 1989 dhe 13 Tetorit 1999 para KKPB-së dhe

kërkesat lidhur me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në mes 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999 para KKP-së. Sa i përket palës përgjegjëse, veçoria e dispozitave (Neni 9 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 e cila e rregullon procedurën para KKP-së dhe Neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079) është se parashtruesi i kërkesës nuk e ka barrën e përcaktimit të identitetit të tij/saj të saktë dhe se përkatësisht i takon Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DPB) apo Sekretariatit Ekzekutiv të AKP-së ta shpall kërkesën te çdo person i cili tani për tani është në shfrytëzim të pronës apo ka qëllim të ketë të drejtë mbi pronën apo të bëjë përpjekje të arsyeshme të informojë çdo person tjetër i cili mund të ketë një interes ligjor mbi atë pronë. Prandaj, i pala përgjegjëse mund të identifikohet gjatë rrjedhës së procedurës kur të jenë marrë më shumë informata rreth tij/saj nga organet administrative, si rezultat i shpalljes së kërkesës.

Rrjedhimisht, në kontekstin e një procedure të tillë të veçantë, fakti se AKP-ja ka mundur të përcaktojë në kohën e procedurës së dytë se I.B. ishte përfundimisht poseduesi i tanishëm i apartamentit në fjalë në vend të vajzës së tij e cila ishte vetëm banore nuk ka ndryshuar vërtetë elementet e gjendjes ligjore sa i përket statusit të palës përgjegjëse. Me fjalë të tjera, pala përgjegjëse e vërtetë është poseduesi i tanishëm i apartamentit dhe emri i tij nuk ndryshon palët e padisë kur paraqitet gjatë procedurës se identiteti i tij është i ndryshëm nga ai që është besuar se është i vërteti në procedurën e njëjtë. Në një situatë të tillë, Gjykata Supreme nuk konsideron se kërkesa e dytë ishte paraqitur kundër një palë përgjegjëse të re.

Prandaj, synimi i kërkesës dhe i palëve në të dy procedurat para KKP-së dhe KKP-së ishin të njëjta.

Megjithatë, kur bëhet vlerësimi nëse është gjykuar më herët një çështje apo jo, nuk duhet të merret parasysh vetëm synimi i parashtruesit të kërkesës por edhe e tërë situata ligjore dhe faktike që është prezantuar në gjykatë.

Në lëndën në fjalë, nuk është e diskutueshme se parashtruesi i kërkesës qartazi kërkonte të merrte ri-posedimin e apartamentit të njëjtë në të dyja procedurat. Megjithatë, për të paraqitur një kërkesë në mënyrë të vlefshme në procedurë të parë, Neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe Neni 1.2 (c) Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 1999/23 që referohet me Nenin 7.1 Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 kërkojnë që parashtruesi i kërkesës duhet të jetë poseduesi i pronës banesore para datës 24 Mars 1999. Për arsye se P.L. nuk ishte në posedim të apartamentit para datës 24 Mars 1999 siç është pohuar nga ai, KKP-ja hodhi poshtë kërkesën e tij.

Neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i ndryshuar me Ligjin 03/L-079 definon kërkesat të cilat AKP-ja duhet t' i pranojë dhe regjistrojë si kërkesa në lidhje me të drejtën e pronësisë dhe kërkesa që përfshijnë të drejtat e shfrytëzimit të pronës lidhur me pronën e paluajtshme private ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund t' i shfrytëzojë ato të drejta pronësore. Me të deklaruar kështu, nuk përmend asnjë kusht të posedimit të mëparshëm fizik të pronës së paluajtshme siç thuhet shprehimisht në Rregulloren 2000/60.

Prandaj, nëse gjendja faktike e paraqitur si rrjedhojë në Komisione nga parashtruesi i kërkesës ishte e njëjtë, megjithatë bazat ligjore mbi të cilat ai e bazoi kërkesën e tij ia mundësuan atij ti plotësojë kushtet në procedurën e dytë kurse ai nuk mundi t' i plotësojë kushtet ligjore në të parën.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konsideron se nuk ekziston shkelje e dispozitave të ligjit të procedurës kontestimore që pengojnë të gjykohet dy herë lënda e njëjtë.

II-Rregullsitë procedurale të vendimit të KKPK-së:

1- Publiciteti i seancës së KKPK-së:

Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se vendimi i shkallës së parë nuk tregon se a është mbajtur seanca e Komisionit publikisht apo jo.

Procedura para KKPK-së është e përcaktuar me Nenin 11 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe me Aneksin I të Ligjit Nr. 03/L-079 (Aneksi III i mëparshëm i Urdhëresës Administrative (AD) 2007/5).

Sa i përket mënyrës se si KKPK-ja i shqyrton lëndët, për të përcaktuar se a duhet të jetë procedura publike apo jo, Neni 11.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 përcakton se, kur është në interes të drejtësisë, Komisioni mund të kërkojë të mbajë një shqyrtim. Në përputhje me Nenin 1.1 të Aneksit III të UA 2007/5 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mblidhet në seanca apo kolegje. Neni 1.7 i të njëjtit përcakton se këshillimet e Komisionit mund të mbahen përmes ndihmës së mjeteve elektronike. Më tutje, Neni 5.1 thotë: “Procedurat para Komisionit do të bazohen në parashtrësia me shkrim dhe, kur është në interes të drejtësisë, në shqyrtime verbale.” Neni 5.2 parasheh: “Shqyrtimi verbal do të mbahet në publik”.

Prej të gjitha këtyre dispozitave, duket se si parim, procedurat para Komisionit janë vetëm me shkrim. Kur gjykata shqyrton një lëndë përmes procedurës me shkrim, domosdo mban edhe seancat e saj pa praninë e publikut. Kjo shpjegon se kushti për seanca publike parashihet me ligj vetëm për shqyrtimet verbale, çka do të thotë se kjo nuk kërkohet kur shqyrtimi verbal nuk konsiderohet si i domosdoshëm për gjykimin e një kërkesë. Ligji po ashtu përcakton se mbajtja e shqyrtimeve verbale është në duart e Komisionit nëse konsideron se është në interes të drejtësisë.

Në këtë lëndë, Komisioni ka shqyrtuar lëndën përmes parashtrësive me shkrim të paraqitësit të kërkesës dhe raportit të AKP-së pa vendosur për të mbajtur një shqyrtim verbal. Prandaj vendimi i kundërshtuar i shkallës së parë i KKKP-së nuk mund të përmbajë informatat se seanca është mbajtur publikisht pasi që një publicitet i tillë nuk është kërkuar.

2- Indikacioni i përbërjes së Komisionit:

Pala përgjegjëse në ankesë pohoi se vendimi i ankimuar nuk tregon se cila ishte përbërja e Komisionit, kush ishte Kryetar dhe kush e kishte nënshkruar vendimin.

Sa i përket përbërjes së KKKP-së, siç pohohet nga pala përgjegjëse në ankesë, Gjykata Supreme vëren se vendimi i shkallës së parë i KKKP-së nuk përmend emrat e anëtarëve të Komisionit e as emrin e Kryetarit por qartazi tregon se Kryetari ka nënshkruar vendimin.

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme duhet të ekzaminojë dy pyetjet e para të ngritura nga pala përgjegjëse në ankesë lidhur me përbërjen e Komisionit dhe identitetin e Kryetarit. Mirëpo, pyetja e tretë e lidhur me identitetin e anëtarit të Komisionit që nënshkroi vendimin e ka përgjigjen në leximin e vendimit.

Në përputhje me Nenin 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, dispozitat e Ligjit të Procedurës Administrative do të zbatohen mutatis mutandis ndaj procedurës së Komisionit.

Nenet 109 dhe 111 të Ligjit Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative parashohin se palët e interesuara duhet tu dërgohen aktet administrative përmes të cilave, në mes tjerash, se vendimet lidhur me pretendimet e tyre janë arritur dhe se njoftimi duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- “a) tekstin e plotë të aktit administrativë;*
- b) emrin e personit përgjegjës për aktin dhe datën;*
- c) emrin e organit që ka kompetencë për të vendosur lidhur me pranimin e ankesave kundër aktit dhe afatet kohore përkatëse.”*

Gjithashtu neni 8.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 thotë:

“Një anëtar i Komisionit përjashtohet nga marrja pjesë në procedure kur ekzistojnë kushtet për përjashtim sikurse janë përcaktuar me nenin 29 të Ligjit mbi Procedurën Administrative.”

Nga këto dispozita rrjedh se vendimet e KKPes duhet të përmendin emrat e anëtarëve të cilët i lëshojnë ato. Së pari është parashikuar, shprehimisht, me ligj të lartpërmendur që çdo akt administrativ, aq më tepër një vendim i shkallës së parë, duhet të përmbajë emrat e autorëve të saj. Së dyti, përmendja e emrave të tyre është e nevojshme në mënyrë që të jenë në gjendje për të kontrolluar nëse ka një shkak për përjashtim të ndonjë anëtari të Komisionit për të vendosur për lëndën.

Megjithatë, KKKP-ë në kohën e vendimit të ankimuar si edhe në kohën e tanishme, ishte dhe është e përbërë ende nga një kolegji i vetëm me tre anëtarë emrat e të cilëve ishin lehtësisht dhe madje edhe të njohur publikisht sepse ata u paraqit në faqen e saj në internet. Kryesuesi u tregua gjithashtu qartë në mënyrë që ankuesi nuk mund të vuajë nga ndonjë pamundësi për të identifikuar anëtarët përgjegjës për gjykimin e kërkesës së tij.

Prandaj, Gjykata Supreme mbetet në atë se e drejta e ankuesit për të ditur përbërjen e Komisionit dhe emrin e Kryesuesit nuk ka qenë kurrë e shpërfillur dhe arrin në përfundimin se mungesa e përmendjes të emrave të autorëve në kuadër të vendimit të ankimuar nuk e ka ndryshuar vlefshmërinë e saj.

3- Informacion në lidhje me personin raportues nga AKP-ja:

Ankuesi gjithashtu pretendoi se emri, pozicioni dhe aftësia për të folur gjuhën e përdorur në kërkesë të personit raportues nga AKP-ja nuk janë specifikuar në vendimin e kontestuar.

Gjykata Supreme vërteton se këto të dhëna nuk janë treguar në vendimin e ankimuar. Megjithatë, ajo vëren se ankuesi nuk e ka sjellë bazën ligjore të kërkesës së tillë të pretenduar.

Në bazë të nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Sekretariati Ekzekutivë i AKP-së ka përgjegjësinë për regjistrimin e kërkesave dhe të përgjigjeve në kërkesat, për të njoftuar palët dhe për të përgatitur kërkesat dhe përgjigjet në kërkesat për shqyrtim nga Komisioni. Nenet 4.1 dhe 4.5 të Aneksit II të UA Nr. 2007 / 5, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 parashikojnë se Sekretariati Ekzekutivë *‘mund të bëjë hetime mbi kërkesën’* dhe *‘do të përgatisë kërkesat duke përfshirë edhe parashtrësat dhe provat, përkthimet e provave, dhe rekomandimet në lidhje me të gjitha kërkesat, ..., për shqyrtim të Komisionit.’*

Asnjë nga këto dispozita nuk parashikojnë që emri i personit raportues të kërkesës duhet të përmendet në vendim, e as Ligji mbi Procedurën Administrative.

Nenet 84 dhe 111 të këtij ligji, që lidhen me përmbajtjen e aktit administrativë dhe të njoftimit të aktit administrativë parashikojnë se akti dhe njoftimi duhet të përmbajnë emrin e organit të administratës publike që ka lëshuar aktin dhe nënshkrimin e udhëheqësit të organit të administratës publike që lëshon aktin ose të drejtuesit të organit kolektiv. Megjithatë, një kërkesë e tillë nuk është kërkuar për veprimet përgatitore të një akti administrativë.

Megjithatë, shkresat e lëndës të ofruara nga AKP-ja që tregojnë emrat e anëtarëve të personelit që pasuan verifikimet e parashtrësive të palëve dhe të cilët shkruan raportin për Komisionin janë treguar qartë në çdo dokument dhe që këto dokumente janë nënshkruar nga ana e tyre.

Gjykata Supreme nuk mund të ndjek shqetësimin e ankuesit për aftësinë e anëtarëve të personelit të AKP-së për të kuptuar gjuhën serbe të cilën ai e përdori në kërkesën e tij. Ky aspekt i procedurës ka qenë padyshim i marrë parasysh nga ligjvënësi duke dhënë shprehimisht në Sekretariatit Ekzekutivë, mes tjerash, detyra për të përkthyer prova për Komisionin.

Për më tepër, në bazë të nenit 3 të UA Nr. 2007 / 5 të ndryshuar, *‘gjuhët që mund të përdoren nga AKP-ja në të gjitha procedurat në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/ 50, do të jenë shqipe, serbe dhe angleze.’*

Në përputhje me këto dispozita, KPA-ja si një organ i tërë është e pajisur me përkthyes dhe / apo anëtarë të personelit për të siguruar që të tri gjuhët fliten dhe kuptohen.

4-Vendimi grupor:

Ankuesi pohoi se nuk kishte baza për të lëshuar këtë vendim grupor, sepse ai nuk kishte asnjë marrëdhënie ligjore me parashtruesit e tjerë të kërkesës dhe kërkesat nuk janë të bazuara në bazë të ngjashme ligjore.

Megjithatë, neni 8.8 të Aneksit III të UA 2007 / 5 i ndryshuar me Ligjin 03/L-079 i mundëson Kryesuesit, nëse numri i kërkesave të vendosura në një seancë është i lartë, për të nënshkruar një vendim grupor që miraton të gjitha vendimet individuale të identifikuara në vendimin grupor. Nëse kjo ndodh, një vendim individual do të verifikohet nga një komisionerë më i lartë i caktuar nga Komisioni ose nga Drejtori i Sekretariatit Ekzekutivë.

Edhe pse, lëshimi i një vendimi grupor është në zgjedhjen e KKPK kur ajo ka të bëjë me një numër të madh të kërkesave në sesionin e saj. Ligjvënësi ka ngritur një procedim të kërkesave masive dhe ka parashikuar mundësinë për të kombinuar grupet e kërkesave për një vendim të konsoliduar ose të përbashkët. Kjo procedurë e jashtëzakonshme e merr në konsideratë nevojën për të individualizuar vendimin me anë të lëshimit të një certifikate individuale.

Mungesa e marrëdhënieve midis paditësve dhe / apo ngjashmëritë e bazës ligjore të kërkesave nuk janë kushte ligjore për lëshimin e një vendimi grupor.

Prandaj Gjykata nuk e ndjek këtë argument kundër rregullsisë të një vendimi të ankimuar.

III- Meritat e kërkesës:

Faktet mjaft të thjeshta të padiskutueshme të lëndës nuk ishin vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë nga raporti i Sekretariatit Ekzekutivë të KKKP-së, dhe, të kompletuara, me vendimin e shkallës së parë i cili shprehimisht i referohet asaj në paragrafin e saj 8.

Ato janë si më poshtë: apartamenti kontestuese është zënë nga familja e I.B. nga viti 1999. Ndërtimi i saj ishte ende në vazhdim në fillim të 1999 kështu që ankuesi nuk mundi të hyjë në të, para se ajo të ishte zënë nga i padituri. Gjithashtu mund të konsiderohet si fakt që rrethanat e njohur të periudhës pas konfliktit në Kosovë mund të ketë penguar ankuesin për të ardhur në Prishtinë për të marrë në posedim këtë apartament.

Jo këto fakte por fakti i pretenduara nga ankuesi se ai ishte mbajtës i të drejtës pronësore mbi banesën në fjalë që nga fillimi i 1999 është kontestues.

Për të kundërshtuar vendimin në lidhje me vlerësimin për këtë fakt dhe për shkak të analizës së dokumenteve që ai ka dërguar, ankuesi ka ngritur tri argumente që Gjykata Supreme ka tani për ta shqyrtuar.

Së pari, ankuesi deklaroi se pamundësia për Sekretariatit Ekzekutivë për të gjetur në të dhënat e organeve administrative çdo rrugë të dokumenteve që ai ka dërguar, nuk mund të çojë KKPK në përfundimin se ato dokumente nuk mund të sjellin në mënyrë të vlefshme prova të së drejtës së tij për posedim.

Për të provuar të drejtën e tij poseduese, ankuesi ka paraqitur tri dokumente të përshkruara në pjesën e këtij aktgjykimi lidhur me sfondin procedural dhe faktik. Përgjegjësia e AKP-së përmes Sekretariatit Ekzekutivë të saj ishte për të verifikuar këto dokumente ashtu siç është paraparë me ligj: në pajtim me nenin 4.2 të Aneksit I të UA 2007 / 5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Sekretariati Ekzekutivë i KPA-ja ka përgjegjësinë për të hetuar kërkesat, për të marrë prova të rëndësishme për kërkesat nga çfarëdo regjistri të organeve publike, të korporatave apo personave civil dhe t'i procedoj për çdo verifikim të dokumenteve mbështetëse të kërkesave.

Sipas këtij verifikimi, duket se kontrata mbi mjetet e bashkuara e datës 9 shtator 1998, e arritur në mes të Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe Ndërmarrjes Publike Banesore nuk kishte hyrë kurrë në fuqi pasi që Kuvendi Komunal i Prishtinës nuk e ka paguar shumën e parave e përcaktuar me nenin 5 të kontratës brenda afatit prej tri ditësh nga dita kur është lidhur kontrata. Me këtë kontratë, Kuvendi Komunal i Prishtinës është dashur të investojë mjete financiare në projektin e ndërtimit të një ndërtese në mënyrë që të marrë të drejtën e pronësisë mbi dy apartamentet e kësaj ndërtese, në mesin e tyre banesa kontestuese.

Ankuesi nuk ka sjellë ndonjë dokument që qon Gjykatën Supreme për të mohuar këtë verifikim.

Prandaj, ai konsideron se KKPK ka vlerësuar drejt se nuk është më e diskutueshme se kjo kontratë nuk u ekzekutua asnjëherë.

Për sa i përket dy dokumenteve të tjera të parashtruara nga ankuesi, Sekretariati Ekzekutivë ka vërejtur se ato nuk mund të gjenden as në arkivat e Kuvendit Komunal të Prishtinës për arsyen se dokumentacioni i para vitit 1999 është marrë jashtë Kosovës, e as në të dhënat e Ndërmarrjes Publike Banesore e cila ka sqaruar se ndërtimi i ndërtesës nuk u përfundua në vitin 1999.

Gjykata Supreme konsideron se KKPK saktë ka vlerësuar se, për shkak të mungesës së dokumenteve në të dhënat e organeve administrative përgjegjëse për ndarjen e një apartamenti dhe të përfundimit të një marrëveshje qiraje mbi atë për një periudhë të pacaktuar kohe, kërkesa për ri posedim e paraqitur nga ankuesi duhet të refuzohet.

Ajo vëren se vendimi administrativë i ndarjes së banesës, i datës 19 Janar 1999, dhe marrëveshja e qirasë, e datës 19 Shkurt 1999, janë lëshuar gjatë konfliktit në një kohë kur ndërtimi i ndërtesave nuk ishte përfunduar. Ai vëren se vendimi i ndarjes së banesës për P.L., të nënshkruar edhe nga P. L. si sekretar i Sekretariatit për Çështje Banesore Komunale të Kuvendit Komunal të Prishtinës, është lëshuar edhe pse Komuna e Prishtinës nuk ishte pronar i apartamentit të ardhëm të ndërtesës në ndërtim pasi që kontrata për bashkimin e mjeteve nuk ka hyrë në fuqi. Për më tepër, ankuesi nuk arriti të sjellë ndonjë provë që do të kundërshtonte rezultatin e verifikimit të dokumenteve që ai ka dërguar.

Duke i pasur parasysh të gjithë këta faktorë, Gjykata Supreme arrin në përfundimin se ankuesi nuk arriti të sjellë prova të së drejtës së tij të posedimit.

Me argumentin e tij të dytë, ankuesi ka mohuar çdo vlefshmëri për një ndarje të mundshme të mëtejme të të njëjtit apartament të paditurit. A

Gjykata Supreme nuk mund ta ndjek ankuesin në këtë argumentim. Mungesa e supozuar e vlefshmërisë së çdo kontrate tjetër të mundshme që ka të bëjë me të drejtën e pronësisë mbi banesën kontestuese nuk u mor parasysh nga vendimi i ankimuar. Me fjalë të tjera, vlefshmëria e dokumenteve të paraqitura nga ankuesi nuk ishte mohuar në bazë të vlefshmërisë së një kontrate të mëvonshme mbi të njëjtën pronë. Kështu, çdo diskutim në lidhje me vlefshmërinë e të drejtës së palës përgjegjëse për të poseduar banesën nuk ka asnjë rëndësi për të vlerësuar vlefshmërinë e dokumenteve që mbështesin kërkesën dhe ankesën.

Në fund, ankuesi pohoi se përpjekja e anëtarëve të familjes të paditurit për të marrë nga ai një marrëveshje për blerjen e banesës sjellë prova se ai ishte mbajtës i ligjshëm i të drejtës pronësore.

Ky argument nuk mund të merret, po ashtu nga Gjykata Supreme pasi që një diskutim i tillë eventual ndërmjet palëve nuk është aspak i provuar me asnjë deklaratë të palës përgjegjëse ose nga ndonjë dokument. Për më tepër, edhe në qoftë se u zhvilluan negociatat e tilla në mes të palëve, ajo ndoshta

mund tu lejojë palëve arritjen e një zgjidhje miqësore, por kjo nuk mund të sjellë në vete dëshmi se dokumentet e paraqitura nga ankuesi ishin të vlefshme.

Bazuar në konsideratat e mësipërme dhe në përputhje me nenet 12.3 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, Gjykata Supreme vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e Procedurës:

Në bazë të nenit 8.4 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative (UA) 2007 / 5 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët janë të liruar nga shpenzimet e procedurës në Sekretariatit Ekzekutivë dhe Komision.

Sidoqoftë përjashtimi i tillë nuk është paraparë për procedurën në Gjykatën Supreme.

Si pasojë, regjimi normal i taksave gjyqësore siç parashihet me Ligjin për Tarifat e Gjykatës së (Gazeta Zyrtare e KSAK-3 tetor 1987) dhe me UA nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Unifikimin e Tarifave të Gjykatës janë të aplikueshme për procedurën para Gjykatës Supreme.

Kështu, taksat e gjykatës të mëposhtme zbatohen për procedurën e ankesës së tanishme:

- Tarifa e taksës gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 I UA 2008/2): 30 €
- Tarifa e taksës gjyqësore për lëshimin e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë mund të vlerësohet arsyeshëm si vlerë që përfshinë shumën në mes të 5.001 dhe 10.000 €: 50 €.

Këto taksa gjyqësore do të barten nga ankuesi i cili humb lëndën.

Sipas nenit 46 të Ligjit mbi Taksat e Gjykatës, afati i fundit për pagesën e taksave nga një person me vendbanim jashtë shtetit nuk mund të jetë më pak se 30 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që, në lëndën aktuale, taksat gjyqësore do të paguhën nga ankuesi brenda 90 ditëve nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij.

Këshillë Ligjore

Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme ose të jashtëzakonshme.

Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e kolegjit të EULEX-it

Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX -it